

VENDIM
Nr. 506, datë 17.7.2019

PËR MIRATIMIN E KODIT TË ETIKËS SË VULLNETARIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 27 e 29, pika 1, të ligjit nr. 45/2016, “Për vullnetarizmin”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kodit të etikës së vullnetarit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KODI I ETIKËS SË VULLNETARIT

Neni 1
Vullnetarizmi

Vullnetarizmi është një forcë pozitive për një qytetari të përgjegjshme, veprim social, shërbime cilësore, komunitete dhe shoqëri civile të shëndetshme. Vullnetarizmi e bën shoqërinë më të ndjeshme dhe të kujdesshme.

Neni 2
Qëllimi

Kodi i etikës së vullnetarit ka për qëllim të vendosë disa rregulla formale për sjelljen e vullnetarëve në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3
Subjekti

Ky kod zbatohet për të gjithë personat që ushtrojnë veprimtarinë e vullnetarizmit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4
Trajtimi me respekt

Vullnetari trajtohet me mirësjellje dhe respekt nga të gjithë personat e lidhur me procesin e vullnetarizmit.

Neni 5
Partneriteti

Individi, që zgjedh të kryejë punë vullnetare, shpreh dëshirën e tij për të kontribuar dhe bashkëpunuar. Për këtë arsye, zgjedhja e tij e detyron ofruesin e vullnetarizmit të formulojë

rregulla që rregullojnë partneritetin e tij me vullnetarin dhe t'i shohë këto rregulla si pjesë e pandashme e të drejtave të vullnetarit.

Neni 6

Informacioni

1. Vullnetari ka akses ndaj informacionit të ofruesit të vullnetarizmit për çështjet e punës së tij vullnetare, si politikat, rregulloret, planet e punës dhe raportet fiskale.

2. Vullnetari merr informacion të detajuar për pozicionin e vendit të punës që i është ofruar, sasinë e kohës dhe burimet që kërkohen për kryerjen e punës. Gjithashtu, ai ka të drejtë të marrë informacion të shkruar për të drejtat e tij si vullnetar.

Neni 7

Mosdiskriminimi

Vullnetari nuk diskriminohen për shkak të gjinisë, orientimit seksual, statusit martesor, shtatzënisë, të qenit prind, moshës, besimit fetar, shtetësisë, origjinës, racës, prejardhjes, përkatësisë politike, aftësisë së kufizuar ose të qenit i lidhur me një person me aftësi të kufizuara apo për shkak se ka kryer një vepër penale, për të cilën ai ka kryer dënimin sipas legjislacionit në fuqi. Përcaktimet e vendosura këtu nuk aplikohen nëse një pozicion specifik shërbimi vullnetar kërkon kufizime.

Neni 8

Pozicioni i punës

Duke marrë në konsideratë qëllimet dhe kërkesat e ofruesit të vullnetarizmit, vullnetari ka të drejtë të zgjedhë një pozicion që përputhet me prirjen dhe aftësinë e tij personale, arsimimin dhe eksperiencën e tij të punës.

Neni 9

Koha e punës vullnetare

Në përputhje me nenin 11, të ligjit nr.45/2016, "Për vullnetarizmin", dhe duke pasur parasysh politikat, qëllimet dhe kërkesat e ofruesit të vullnetarizmit, vullnetari, në bashkëpunim me ofruesin e vullnetarizmit, përcakton sasinë e kohës që ai i kushton kryerjes së punës vullnetare.

Neni 10

Rritja profesionale

Në varësi të nevojave të ofruesit të vullnetarizmit, vullnetari ka të drejtë për rritje dhe zhvillim profesional në punë, bazuar në preferencat e tij personale dhe aftësitë e tij.

Neni 11

Kushtet e punës vullnetare

Vullnetari ka të drejtë të ketë kushte të përshtatshme pune. Atij i vihen në dispozicion të gjitha burimet dhe kushtet fizike të nevojshme për të kryer punën e tij vullnetare dhe punon në një mjedis pune të sigurt. Nevojat e vullnetarit me aftësi të kufizuar (PAK) merren në konsideratë në mënyrë të veçantë.

Neni 12
Vlerësimi

Në përfundim të kontratës së vullnetarizmit, ofruesi i vullnetarizmit vlerëson punën/shërbimin e kryer/ofruar nga vullnetari.

Neni 13
Kryerja e detyrës

Vullnetari ka për detyrë ta bëjë në mënyrën më të mirë të mundshme punën e tij.

Neni 14
Dhuratat gjatë kryerjes së punës vullnetare

Vullnetari nuk duhet të pranojë dhurata apo përfitime të asnjë forme nga përfituesit e vullnetarizmit apo persona të tjerë.

Neni 15
Konflikti i interesit

Vullnetari ka për detyrë të shmangë konfliktet e interesit. Vullnetari, që e gjen veten e tij në një konflikt interesi, duhet ta vetëdeklarojë atë. Vullnetari shmang përfshirjen në çdo formë vetëpunësimi ose biznesi privat, që konkurren me shërbimet apo programet e ofruesit të vullnetarizmit ku ai ushtron vullnetarizmin.

Neni 16
Influencimi i vullnetarëve të tjerë

1. Vullnetari nuk përdor pozicionin e tij si vullnetar për të influencuar vullnetarët e tjerë, stafin ose ofruesin e vullnetarizmit.
2. Vullnetari, që mund të gjendet në një pozicion autoriteti, nuk duhet të abuzojë, të ushtrojë influencë të papërshtatshme apo të kërcënojë një vullnetar tjetër apo anëtar të organizatës/ofruesit të vullnetarizmit.

Neni 17
Përdorimi i pijeve alkoolike dhe substancave narkotike gjatë detyrës

Vullnetari nuk duhet të paraqitet nën efektin e pijeve alkoolike apo të substancave narkotike dhe nuk duhet t'i përdorë ato në vendin e ofrimit të vullnetarizmit.

Neni 18
Komunikimi/ndërveprimi me të tjerët

1. Vullnetari nuk përdor fjalë të papërshtatshme dhe nuk shqetëson vullnetarët e tjerë apo pjesëtarë të ofruesit të vullnetarizmit.
2. Vullnetari ndërvepron me vullnetarët e tjerë, stafin e ofruesit të vullnetarizmit dhe anëtarët e publikut në mënyrë profesionale, të sjellshme, dinjitoze, të respektueshme, të drejtë e të barabartë.
3. Vullnetari nuk vë në lojë apo në siklet një punonjës apo një vullnetar tjetër. Kjo mund të përfshijë fjalë që mund të jenë ofenduese ose dëmtuese ndaj marrëdhënies së vullnetarizmit.

4. Vullnetari nuk sillet në mënyrë të tillë që shqetëson, poshtëron ose krijon një ambient jo të rehatshëm pune për vullnetarët e tjerë.

5. Vullnetari nuk ngacmon të tjerët për shkak të racës, prejardhjes, kryerjes së një vepre penale, për të cilën ai ka kryer dënimin sipas legjislacionit në fuqi, statusit martesor, statusit të partneritetit me partner të së njëjtës gjini, statusit familjar apo aftësisë së kufizuar.

6. Vullnetari trajton këdo me dinjitet dhe respekt.

Neni 19

Procedura e ankimit

1. Në rast se një vullnetar beson se ai apo ajo është trajtuar në kundërshtim me këtë kod etike:
 - a) ai komunikon drejtpërdrejtë me personin dhe i kërkon që të ndalojë sjelljen e tij/saj;
 - b) njofton mbikëqyrësin e tij/saj apo koordinatorin e programit;
 - c) mbikëqyrësi i vullnetarit takohet me personin për të cilin është bërë ankesa, për t'i dhënë atij/asaj një mundësi për të paraqitur këndvështrimin e tij të gjërave;
 - ç) mbikëqyrësi i vullnetarit merr një deklaratë me shkrim nga personi, ndaj të cilit është bërë ankesa, që qartëson se ata janë në dijeni për ankesën e bërë ndaj tyre dhe e orienton atë të mos e diskutojë ankesën me asnjë person tjetër;
 - d) mbikëqyrësi i vullnetarit (bashkë me drejtuesin e seksionit të ofruesit të vullnetarizmit) konstaton nëse ankesa është substanciale dhe marrin vendime të veçanta, në varësi të rastit.
2. Ankesa e vullnetarit merret me shkrim dhe me firmën e tij. Ankesa përmban detaje të sjelljes së pretenduar, duke përfshirë datat, kohën, vendet, emrat e individëve të përfshirë dhe çdo dëshmi apo prova.

Neni 20

Marrja e masave

Kur vendoset se ndaj veprimeve të një vullnetari duhet të ndërmerren masa disiplinore, këto masa mund të përfshijnë, por jo të jenë të kufizuara në:

- a) kërkimin e faljes;
- b) trajnim të mëtejshëm;
- c) paralajmërim;
- ç) pezullim;
- d) përfundim.

Neni 21

Ofruesi i vullnetarizmit

Ofruesi i vullnetarizmit:

- a) vlerëson dhe njeh rolin e çdo vullnetari;
- b) shpjegon rolin e çdo vullnetari ndaj klientëve;
- c) edukon stafin për vullnetarizmin;
- ç) siguron që pajisjet apo ambientet fizike ku ushtrohet vullnetarizmi të jenë të sigurta për vullnetarët;
- d) respekton aftësitë e ndryshme të vullnetarëve;
- dh) respekton motivet e tyre për t'u marrë me vullnetarizëm;
- e) respekton konfidencialitetin në shkallën më të lartë që është e mundur;
- ë) mbështet vullnetarët që të kenë rritje personale gjatë këtij procesi;
- f) respekton të drejtat, dinjitetin dhe vlerën e të gjithë njerëzve të përfshirë në vullnetarizëm, pavarësisht gjinisë, aftësisë apo prejardhjes kulturor të tyre;
- g) siguron që eksperiencia e vullnetarizmit të jetë një eksperiencë pozitive.

Dispozita të fundit

Vullnetari duhet të njohë dhe të sillet në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 45/2016, “Për vullnetarizmin” dhe legjislacionin tjetër në fuqi, Kodin e Etikës së Vullnetarit si dhe rregullat e përcaktuara nga ofruesi i vullnetarizmit për të rregulluar procesin e vullnetarizmit.

Kodi i Etikës së Vullnetarit vendoset në vende të dukshme të zyrave të ofruesve të vullnetarizmit. Gjithashtu, çdo informacion që ka të bëjë me detyrat dhe përgjegjësitë e vullnetarit e të ofruesit të vullnetarizmit, sipas ligjit nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin”, bëhet publik në vende të dukshme të zyrave të ofruesve të vullnetarizmit.